



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 185, datë 22.12.2023

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 1'186'856 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 1'186'856 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Vlera përfituese në lekë
1	Bislim Hajdarmataj	1'186'856
Total vlera		1'186'856

2. Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.12.2023






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 926/prot.
3

Durrës, më 22/12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TËBASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.185 datë 22.12.2023 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 1’186’856 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

